

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Lëvizja e studentëve" në Serbi dhe paralelet me "Revolucionin e Flamingove" në Shqipëri
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/levizja-e-studenteve-ne-serbi-dhe-paralelet-me-revolucionin-e-flaming-i587160
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 18:46:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 18:42:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ba26dd9f2201745f96a807e9f2cd97664010165b28e8d6b6a323e8a0471c219c
TEKSTI	536b9b7fc9ea63b16bcd1e60e6602504c0298e84450102999c61e244e4bfc2c
PAMJA	35dbee0f0bf25eaa7b1d37aefac7c6b713430a2ebf7dfb5db61793a0f692d839

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cae10e8bf26bb6ab9277201959bfe280da8c61e379fd1c043ea2e372e7d77ba2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	12839dc4b023db7c55325e9d2ee92462b471b26279290faf1035fe327d267353
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cae10e8bf26bb6ab9277201959bfe280da8c61e379fd1c043ea2e372e7d77ba2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)

English

1e [Nga qasja ushtarake te "karantina" gjeopolitike, cfare hton realisht SHBA-ja ne Grenlande me marreveshjen e Trump "Levizja e studenteve" ne Serbi dhe paralelet me "Re](#)
fundit

“Lëvizja e studentëve” në Serbi dhe paralelet me “Revolucionin e Flamingove” në Shqipëri



19 Shtator 2026, 20:42Blog Nga Fatjona Mejдини

Më 25 tetor, serbët do t'u drejtohen kutive të votimit dhe shqiptarët kanë arsye ta ndjekin këtë proces me interes. Kjo sepse, për herë të parë në këtë skenë politike, ka hyrë një aktor i ri politik, jo tradicional. Janë përfaqësuesit e të ashtuquajturës “Lëvizje Studentore”, të cilët, pas dy vitesh protestash intensive kundër korrupsionit dhe autoritarizmit në qeveri, janë regjistruar në zgjedhje si një lëvizje politike.

Në këto zgjedhje, ata nuk hyjnë për pjesëmarrje apo për konfirmim, por për t'i fituar ato dhe për t'i dhënë fund një regjimi të instaluar nga Aleksandër Vuçiq prej 14 vitesh, përmes partisë së drejtuar prej tij, Partisë Progresive Serbe (SNS).

Sondazhet e qendrave dhe instituteve të pavarura i nxjerrin gjithashtu favoritë. Instituti serb Mendimi i Ri Politik (NSPM) parashikon që “lista e studentëve” të marrë në zgjedhje 39,6% të votave, kundrejt 37,5% të koalicionit të drejtuar nga SNS. Po kështu, Qendra për Hulumtime, Transparencë dhe Përgjegjësi (CRTA) parashikon që ata të grumbulojnë 44,9% të votave, krahasuar me vetëm 35,7% të koalicionit të drejtuar nga partia në pushtet.

“Lëvizja Studentore” do të garojë me një listë prej 250 kandidatësh për deputetë, të cilët janë përzgjedhur në mënyrë të decentralizuar dhe janë vetuar me rigorozitet për sa i përket të shkuarës së tyre profesionale, politike dhe zbatimit të ligjit. Lista kryesohet nga një mjek kardiolog nga Novi Sadi dhe vijon me profesionistë të fushave të ndryshme, ku mbizotërojnë akademikët nga universitetet e Serbisë.

Me një program prej 11 pikash, që ka në thelb të tij “rimëkëmbjen e vendit”, theksi vendoset te lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe te aspekti social i zhvillimit të vendit, me më shumë vëmendje ndaj arsimit dhe kujdesit social.

Paralelet me Shqipërinë

Në Shqipëri, këto zgjedhje duhet të vështrohen me kujdes, sepse ka disa paralele të rëndësishme që mund të hiqen mes kësaj lëvizjeje dhe protestuesve të “Revolucionit të Flamingove”.

Lëvizja studentore në Serbi nisi në nëntor të vitit 2024, si rezultat i një ngjarjeje tragjike, ku 16 persona humbën jetën dhe të tjerë u plagosën si pasojë e shembjes së një strehe të një stacioni hekurudhor në Novi Sad, qyteti i dytë më i madh në Serbi. Kjo tragjedi shkaktoi zemërim të gjerë qytetar në Serbi, pasi stacioni sapo ishte rinovuar, dhe solli në vëmendje korrupsionin në prokurimin publik, si dhe vendosjen e interesave të grupeve të biznesit pranë qeverisë përpara interesit publik.

Zemërimi filloi të kanalizohet në protesta, të cilat morën nxitje fillimisht nga Fakulteti i Arteve në Beograd, për t'u përqafuluar më pas nga universitetet e tjera në të gjithë vendin dhe për t'u shtrirë në mënyrë horizontale në të gjithë Serbinë. Lëvizja u bë një kërcënim i fortë si për pushtetin e Aleksandër Vuçiqit, ashtu edhe për opozitën e vjetër në Serbi, e cila kishte humbur peshën e saj dhe shihej gjerësisht si e paaftë për të frymëzuar ndryshim.

Për dy vjet me radhë, studentët dhe qytetarët në të gjithë vendin zhvilluan një valë protestash, herë me bllokime rrugësh dhe herë duke mbushur sheshet. Më 15 mars të vitit 2025, protesta nxori më shumë se 300 mijë persona në sheshin kryesor të Beogradit, duke u cilësuar si lëvizja më e madhe qytetare në historinë e Serbisë.

Kërkesat nisën me bërjen transparente të dokumentacionit për rindërtimin e stacionit hekurudhor në Novi Sad dhe, me kalimin e kohës, u zgjeruan duke përfshirë kërkesa për më shumë buxhet për arsimin në Serbi, më shumë mbështetje sociale dhe, më pas, për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Theksi u vendos gjithashtu te autoritarizmi i pushtetit të Vuçiqit dhe nevoja për një fillim të ri.

Protesta u bë një mjet i kanalizimit të pakenaqesise se pergjithshme me pushtetin. Kjo ka ndodhur edhe me protesten ne Shqiperi, e cila nisi ne fund te majit si zemerim ndaj efektit ne faune dhe mjedis qe pritej te shkaktonte ndertimi i nje projekti turistik ne Zvernes, projekt i lidhur me familjen e presidentit te SHBA-se Donald Trump.

Protesta prodhoi një mobilizim qytetar të pazakontë për Shqipërinë. Dijetëria mijëra qytetare doli në rrugë dhe mbushën bulevardin kryesor të Tiranës, ndërsa interesi i mediave ndërkombëtare i dha protestës jehonë të mëtejshme. Ajo u shndërrua në një nga protestat më të mëdha të zhvilluara në vend që prej rënies së komunizmit, afro tre dekada më parë. Për më tepër, fakti që protesta vijoi në mënyrë maratonë për më shumë se 100 ditë e bëri mobilizimin dhe qëndrueshmërinë e saj veçanërisht të pazakontë.

Lëvizja e krijuar mori emrin “Revolucioni i Flamingove”. Me kalimin e kohës, ajo nuk zgjeroi vetëm numrin e mbështetësve, por edhe numrin e arsyeve për të cilat protestohet. Korrupsioni, vendosja e interesave private përpara atyre publike, rritja e autoritarizmit dhe arrogancës qeveritare u bënë disa nga arsyet që i nxorën qytetarët çdo ditë në protestë përpara Kryeministrit. Shpejt, kërkesa dominuese dhe e panegociueshme e protestuesve u bë dorëheqja e kryeministrit Rama.

Një tjetër paralele mes protestave në Serbi dhe atyre në Shqipëri lidhet me distancën që të dyja lëvizjet kanë mbajtur nga partitë tradicionale. Në Serbi, studentët kanë ruajtur distancën jo vetëm nga partia në pushtet e drejtuar nga Aleksandër Vuçiqi, por edhe nga Partia e Lirisë dhe Drejtësisë (SSP), një nga forcat kryesore të opozitës, si dhe nga forcat e tjera më të vogla, duke preferuar të mos identifikohen me to.

Një qasje të ngjashme ka ndjekur edhe “Revolucioni i Flamingove” në Shqipëri, duke u pozicionuar në distancë të barabartë nga partitë e konsideruara si pjesë e establishmentit politik dhe duke refuzuar bashkëpunimin edhe me Partinë Demokratike në opozitë. Slogani “RnB, BnB” është një lojë fjalësh me tone muzikore, që nënkupton kërkesën që të dy liderët politikë, në mazhorancë dhe në opozitë, të shkojnë në burg: “Rama në burg, Berisha në burg”.

Protesta në Shqipëri megjithatë mbështetet fuqimisht nga parti të reja politike, por në thelb mbetet një lëvizje qytetare e zemërimit. Ajo nuk ka një lider të identifikuar dhe ka preferuar të ruajë si identitet mobilizimin qytetar dhe jo atë partiak. I njëjti ka qenë edhe rasti i “Lëvizjes Studentore” në Serbi. Kjo lëvizje nuk ka një lider të identifikuar, por ky fakt nuk duket se e ka penguar të sfidojë një pushtet autoritar dhe të konsoliduar prej më shumë se një dekade në Serbi.

Testi i 25 tetorit në Serbi do të tregojë ecurinë e këtyre lëvizjeve në terrenin elektorat. Suksesi i saj mund të frymëzojë një rrugë të re për lëvizjen protestuese në Shqipëri dhe t’i japë asaj një indicje se mund ta sfidojë pushtetin jo vetëm simbolikisht, por edhe përmes zgjedhjeve, pra realisht.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Kazerma e GJKKO-së së Shkallës së Parë duhet bojkotuar komplet!

19:45 Blog / 4 komente

Ku gabuam...?

19:15 Blog / 14 komente

[Pas deklaratës së Kuvendit tek veprimi: Çfarë duhet të bëjë Shqipëria për Kosovën](#)

17:55 Blog / 15 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.